



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Protokolli i Dëgjësës Publike në kuadër të Projekt-Rregullores “ Për menaxhimin e Mbetjeve të Ngrurta Urbane”

Data 04.10.2023 ora 11:00

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Relaton sipas materialit të përgatitur Zj.Ina Xhakoni, Përgjegjëse pranë drejtorisë të shërbimeve Publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës në Bashkinë Shkodër mbi projekt rregulloren : “ Për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane (MNU) Bashkia Shkodër”.

Ajo gjithashtu shprehet se kërkon të dijë nga qytetarët dhe bizneset se cilët orare do të ishin të përshtatshme për to, në mënyrë që operatorët e pastrimit të tërheqin mbetjet e tyre duke mos patur probleme me ngarkesën e pikave dhe dorëzimin e mbetjeve në cdo orar, sepse në të kundërt kjo projekt-rregullore parashikon penalitete dhe gjoba.

Në fund të prezantimit, u kërkua të marrin fjalën të gjithë kush kishte pyetje apo sugjerime nga ana e të pranishmëve.

Pyetje nga salla

Adi Garuci/ Qytetar

Pse fashat orare për qytetarët ndryshon nga rregullorja tek prezantimi? Per mbetjet e gjelberta? A lejohet te hidhen ne kazane ? Permiresimi i sherbimit te pastrimit a do sjelle për pasojë taksa shtese për qytetarët?

Përgjigje:

Ina Xhakoni

Në prezantim është vendosur opsioni më i mirë për një ambient më të pastër , duke respektuar frekuencat e evadimit që pikat të jenë gjithmonë të pastra . Ndërsa draft-rregullorja është për konsultim, do rishikohet para se të kalojë për miratim me të gjitha vërejtjet apo sugjerimet përkatëse nga grupi I punës.

Është parashikuar që me kalimin e kohës dhe me zbatimin e rregullores do të kërkohet që në tre periudhat e vecanta të vitit kur ka prerje dhe krasitje bahcesh të caktohet një ditë dhe një orar I caktuar për të evaduar mbetjet e gjelbërta. Rregullorja sjell disiplinimin e dorëzimit të mbetjeve në pikat e grumbullimit, kjo do të sjellë edhe përmirësimin e cilësisë të mjedisit por jo me domosdoshmëri të pasqyrohet në rritjen e tarifës të pastrimit për qytetarët.

Florian Malaj, Qytetar / Nj.a Rrethina

Pyetje: Ura e Bardhajve, Rruga Nacionale, I hedhin mbeturinat kudo, ndalojnë me makina I hedhin ne rruge. Nuk jemi te kenaqur me sherbimin, shpresojme te bëhet dicka ma e mire me rregulloren.

Përgjigje Ina Xhakoni: Jemi në dijeni të problematikës me hedhjen e mbeturinave kudo pa kriter deri dhe djegien e mbetjeve përgjatë lumit Kir në tepe etj. Këtë e kemi ngritur si problem dhe kërkesë për zgjidhje strukturave të tjera që nuk varen nga ne por kanë pranuar të bashkëpunojnë për identifikimin e kundravajtesve nga IKMT dhe policia e shtetit. Me identifikimin e tyre dhe penalizimin do të kërkojmë që të frenohet dukshëm fenomeni ndotës.

Do pergatitemi per sezonin turistik veror. Kontrata aktuale ka pasur problem frekuencat e ulura me 2x/jave, me kontraten e re do jete 3 deri 4x/jave. Frekuenca shtese, dhe ne nj.a Shale. Shembull: Pastrimi me fadrome I Rrethinave, hedhin mbetje prane objekteve te kultit. Kerkojme bashkepunimin e banoreve.

Qytetare anonime

Pyetje : Kam pasur nje kioske, ne njesi administrative, ma kan hequr, me cfare do të mundem me jetu?

Përgjigje Kryetari I Këshillit Bashkiak : Oltion Luli

Shqetesimi mund te trajtohet ne nje moment tjetet, sepse është jashtë objektit të dëgjësës.

Izmir Gurishta/ qytetar dhe përfaqësues biznesi

Pyetje : Shkolla Veterinare, shumfish mbeturina ne krahasim me fotot qe ju prezantuat. Koshat neper trotuare: koshat e vegjel. Kam 1 market ne parruce. Hedhin njerzit mbeturina shtepiake te koshat e vegjel. Kam bërë fjalë me disa persona.

Përgjigje Ina Xhakoni: Nuk duhet te kete konteniere prane shkollave. Ka problem me vendosjen e pikave të grumbullimit. Duhet marre masa , të vendosen gjoba. Rregullorja do sistemoje gjerat. Do informohen dhe do të ndergjegjesohen qytetaret nga Bashkia dhe lagjet ose njësitë administrative. SHkolla Ismail Qemali ka koshat shum prane gjithashtu, do shihen me prioritet për ti larguar koshat nga ambientet e shkollave. Do të synojmë të sistemojmë pikat. Me ane te rregullores, do ndergjegjesojme qytetaret.

Senad Nikshiqi, Gazetar

Pyetje: Biznesi i madh ka mundesi të paguajë cdo dite kundervajtjen administrative, si procedohet nëse e përsërit kundravajtjen?

Përgjigje: Ina Xhakoni: Gjodat përsëriten dhe I drejtohem strukturave të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e Mjedisit sic janë IKMT, si krim mjedisor, nëse i tejkalon kufijte e Kundervajtjeve Administrative.

Bepin Kolvataj

Pyetje : Masat Administrative duhet te ishin aplikuar me kohë, sot është Shkodra qytet i ndotur. Në shume rruge nuk kryhet fshirja, as larja e rrugeve, as dezinfektimi . Shpresoj te permiresohet shpejt.

Higjena: Larje e konteniereve?!

Fasonerite ne fermentim. Nuk ka pasur efekt masa administrative. Si do procedohet per hedhjet e mbetjeve te tyre ne zona jo te lejuara?

SI do procedohet me kundravajtjet administrative ne rrethina ? Me kamera?

Përgjigje: Ina Xhakoni

Ne kemi një rregullore të brëndshme funksionale procedurën standarte të veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për Bashkinë Shkodër , nga ku përcaktohen procedura e monitorim-raportimit të shërbimit të pastrimit. Ne fund te dites kur vihen re sherbimet e munguara ndermerren penalitete per sherbimet e pakryera nga operatoret.

Fasoneritë , jane njoftuar shpesh. Kane munguar gjobat per keto biznese. Me rregulloren, do informohen dhe do të ndergjegjesohen të gjithë. Per mbetjet qe nuk jane pjese e kesaj rregullore, ka ligjet perkatese që rregullojnë menaxhimin me të tretët. I jemi drejtu dhe do I drejtohem i institucioneve perkatese.

Monitorimi: Monitorimi do të vijojë të realizohet nga monitoruesit tane, dhe prioritet do kenë ankesat e qytetareve.

Florian Malaj

Pyetje: Sugjerim për Inertet ? Duhet të jenë të përcaktuara që tek lejet e ndertimit, duhet caktuar ku do hidhen mbetjet e ndertimit nga Bashkia.

Pyetje dhe sugjerime: Plarent Anamali :

Sanksionet Administrative me masën 10,000 dhe e perseritur 20,000. A mendoni se eshte disproporcionale me tarifen e pastrimit ?

Disproporcionale ? Dmth për individë të jetë masë më e vogël, ndërsa për bizneset me e madhe ?

A mendoni qe duhet paraqitur edhe harta e PGM. E miratuar.

Përgjigje Ina Xhakoni: Po, hartat i disponojmë dhe mundet që ti bëjmë pjesë të rregullores.

Per tarifen, aplikohet parimi ndotesi paguan.

Sugjerimi i anetarit : Të behet 5,000 lek gjoba per qytetarin hera e pare e kundravajtjes, 15,000 hera e dyte. Dhe ma shume per biznesin. Se disa biznese pagujn 60,000 lek.

Përgjegje Ina Xhakoni: Maksimumi i vlere se kundravajtjes administrative eshte 20,000 lek sipas ligjit për kundravajtjet administrative.

Rezarta Bode

Pyetje dhe sugjerime: Te kete 3 faza per ndëshkimin. Verejtje, Gjoba 1, dhe Gjoba e perseritur.

Ka keqperdorim te objekteve/koshave, nga firma. Perben kosto per qytetin prishja e konteniereve. Duhet kerkese logarie, larje, dezinfektim I kazaneve.

Përgjigje: Ina Xhakoni: Duhet të jemi sa më miqësorë me mjedisin, sa më të përgjegjshëm të jemi ne aq më mirë do e bëjë punën operatori dhe nuk do gjejë justifikime kur ti dëmtohen kontenierët . Këmi pasur

raste ku kontenieret kanë mbledhur inertet me kontenierë të mbështetur në tokë sepse qytetarët kanë hedhur inerte përreth pikave .

Uarda GJekaj, Keshilltare

Pyetje: Si do i kerkojë bashkia llogari operatorit te pastrimit ? Nuk mjafton gjoba. A eshte parashikuar një hap me tej ? Te mbyllet kontrata direkt prsh kur nuk zbatohet kontrata ?

Përgjigje Ina Xhakoni e shpjegoi kushtin e kontratës kontrates , për cdo penalitet 15% të situacionit mbyllet edhe kontrata .

Uarda: Të kërkohet nga operatori I shërbimit që mos te marrë përsipër të nënshkruajë kontratë nëse nuk merr përsipër të bëjë mirë edhe punën, në këtë rast shërbimin e pastrimit.

Rezarta Bode

Kafshet e ndotura te hedhura ne kazane, duhet te jene pjese e kundervajtjeve administrative.

- Eshte pika O e kundravajtjeve administrative.

PËRFUNDON INA XHAKONI NË ORËN 12:20

Nis prezantimin këshilltari për rendin Z.Pjerin Lazri 12:20

Në lidhje me Projekt- rregulloren, “Për rregulloren “Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin administrativ të bashkisë shkodër”, janë kërkesat, sugjerimet dhe përgjigjet si më poshtë:

Pyetje dhe sugjerime. Znj. Poda: Sugjeron që në këtë rregullore të parashikohet edhe zaptimi i hapësirave publike. Së dyti pyet nëse mund të parashikohet në rregullore nëse pagesa e gjobave bëhet brenda një afati të caktuar, të përfitohet zbritje, siç ndodh me gjobat në fushën e Kodit Rrugor?

Grupi punës sqaron: Termi “zaptim” përdoret në përditshmëri dhe ka të njëjtin kuptim me termin “zënie”, e cila është parashikuar në disa raste në rregullore. Ndërsa në lidhje me mundësinë e pagesës së gjobave të tjera me zbritje siç janë ato për shkeljet e qarkullimit rrugor, sqarojmë se nuk jemi në të njëjtat kushte, pasi ato janë parashikuar ne ligjin specifik.

Pyetje. Z. Anamali pyet, në rast largimi të mjeteve me karrotrec kush do paguajë në rast dëmtimi dhe a ka bashkia vend depozitimi për mjetet e sekuestruara dhe pyetja tjetër është si do të dokumentohet dhe si do të kryhet matja e zhurmave dhe a duhet që kjo duhet përfshirë në rregullore?

Grupi punës sqaron: Përgjegjësinë për zhdëmtimin e dëmit e ka institucioni që merr në ruajtje automjetin, ndërsa në lidhje me dokumentimin dhe matjen e zhurmave, në Ligjin nr.9774, datë

12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” të ndryshuar” në nenin 8 “*Bashkia*”, në pikën “ç” thuhet “Kontrolli me paisje të çertifikuara për matjen e niveleve të zhurmës, të personave fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë, si dhe marrjen e masave administrative, pezullimin apo mbylljen e veprimtarive që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të veprimtarive, që kontrollohen nga organet e tjera të përcaktuara në këtë ligj”. Bashkia do të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Pyetje dhe sugjerime: Znj. Leqejza merr fjalën duke ju referuar pikës 8, gërma f në rregullore dhe kërkon të dijë nëse do të ndalohej vendosja e vazove në ballkone apo do specifikohet mënyra e vendosjes së tyre? Ajo sugjeron qartësimin e tyre në rregullore për të mos patur keqkuptime.

Grupi punës sqaron: Në rregullore janë të specifikuar qartësisht kriteret dhe mënyra e vendosjes së vazove në ballkone, etj. me qëllim sigurimin e jetës dhe pronës së qytetarëve.

Pyetje dhe sugjerime: Znj. Leqejza e merr fjalën përsëri në lidhje me nenin 9 gërma a për zhurmat gjatë punimeve, duke sugjeruar vendosjen e fashave të orarit të mirëpërcaktuara në rregullore. Po ashtu kërkon të dijë si bëhet ndarja 2-5 m lidhur me pastrimin.

Grupi punës sqaron: Ligji nr.9774, datë 12.07.2007, në neni 2 pika ç thuhet se ky ligj nuk zbatohet për: “brenda shtëpisë, brenda mjeteve të transportit dhe brenda vendeve të punës, në rastet kur kjo nuk e kalon nivelin kufi, të miratuar për mjedisin e jashtëm. Për administrimin e zhurmës në vendet e punës zbatohen rregullat, kërkesat dhe masat e miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon shëndetësinë dhe të ministrit që mbulon punën”.

Neni 11. Kushtet për leshuesit e zhurmës.

1. Makineritë, mjetet e transportit, pajisjet e teknologjitë, para se të dalin në treg apo të vihen në përdorim, pajisen me dokumentacionin shoqëruar, që tregon të dhënat për fuqinë e zhurmës që lëshojnë.

2. Personat fizikë dhe juridikë, që zotërojnë e përdorin burimet e zhurmës, plotësojnë kushtet teknike, që garantojnë respektimin e niveleve të zhurmës, të përcaktuara në dokumentacionin shoqëruar.

Gjithashtu largësia 2-5 m përreth biznesit e caktuar që bizneset të bëjnë vetë pastrimin, është përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr.8090, datë 21.03.1996, i ndryshuar, “Për largimin publik të mbeturinave”.

Pyetje dhe sugjerime: Znj. Leqejza kërkon që në nenin 13 të sqarohet termi “rracë e rrezikshme”. Në këto raste ajo sugjeron paisjen e të gjithë qenve me maska dhe po ashtu kërkon të saktësohet zhurma që bëjnë kafshët. Ajo shton se ndalimi i mbajtjes së kafshëve në zonat urbane është i parashikuar edhe në ligjin e veterinarisë, prandaj duhet bashkërendim në këtë pjesë. Gjithashtu sugjeron që të merren masa parandaluese për qentë endacakë dhe lehtësime në penaltetet kur bëhet fjalë për persona me aftësi ndryshe.

Grupi punës sqaron: Në rregullore do të ndryshohet termi “rracë e rrezikshme” në “rracat të tilla si”. Gjithashtu do të shtohet në nenin Neni 13 “Kundërvajtjet administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike”, Transportimi i kafshëve të pa regjistruara/endacakë (qen dhe mace), nga njëri vend në tjetrin, pa lejen e organeve

kompetente si dhe do të shtohet si pikë në nenin 21 “Rrethana lehtësuese”, Kundërvajtja është kryer nga një person me aftësi ndryshe.

Pyetje: Znj. Gjekaj, mendon se lënia e përgjegjësisë së konstatimit të shumë drejtorive do krijonte kaos. Gjithashtu kërkohet të vendoset në rregullore zënia e parkingjeve të dedikuara.

Grupi punës sqaron: Në rregullore është parashikuar “struktura konstatuese”, që mund të jetë Policia Bashkiake, IMT, etj, të cilat veprojnë sipas fushës së përgjegjësisë që përcaktohen në ligj dhe aktet nënligjore. Gjithashtu do të shtohet Neni 8 “Kundërvajtjet administrative në fushën e sigurisë”, zënia e parkimeve të rezervuara nga subjekte të ndryshme, si shkelje administrative.

Pyetje: Znj. Gjekaj sugjeron që duke cituar nenin 16, më parë duhet bërë konfiskimi e pastaj lirimi dhe ajo kërkon të dijë nëse bashkia ka hapësira të përshtatshme, pasi në të kundërt kjo do ishte nul. Për më tepër neni 17, nëse do bëhet paralajmërimi me anë të afishimit publik, media etj. dhe nuk beson se është e nevojshme të vihet në lëvizja drejtoria përkatëse. Gjithashtu tek neni 18, kush e vlerëson që të vendoset një gjobë e caktuar, pasi diferenca mes minimumit dhe maksimumit të gjobës mund të jetë një pikë e mundshme abuzimi. Shqetësimi i saj është se sa e zbatueshme do jetë kjo rregullore dhe a është menduar ndonjë metodologji për mbledhjen e gjobave.

Grupi punës sqaron: Konfiskimi si masë parandaluese është parashikuar në rregullore për t’u përdorur si mjet i fundit, kur masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat. Bashkia do të marrë masa për sigurimin e një magazine për këtë qëllim. Paralajmërimi me shkrim/akt konstatimi është akt administrativ, që ka për qëllim këshillimin që jepet për shkelje të një rëndësie të vogël dhe/apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese. Gjobat sipas rëndësisë së shkeljes do të vendosen në paketën fiskale brenda kufirit të vendosura në rregullore. Metodologjia e mbledhjes së gjobave është njoftimi i detyrimit, bllokimi i llogarive bankare, marrja e 50% e gjiros ditore të biznesit, bllokimi i asetëve, përcaktuar këto në Ligjin nr.9920 “Për procedurat tatimore në RSH”, si dhe në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme, nr. 17, datë 20.06.2022, “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Pyetje: Z.Nikshiqi: pyet nëse është menduar për zhurmën që shkaktojnë ritualet fetare dhe në lidhje me parkimet publike ai mendon më parë duhet t’i afrohen mundësi qytetarëve për të mos bërë shkelje.

Grupi punës sqaron: Zhurma impulsive konsiderohet **përsëritëse** kur verifikohen të paktën **10 herë në një shtrirje kohore të 1 orë** në periudhën e ditës dhe të paktën **2 herë** në harkun kohor të **1 ore** në periudhën e natës. Ky lloj aktiviteti **nuk** gjeneron “zhurmë”. Në lidhje me parkimin e automjeteve Policia Bashkiake e ka për detyrë të zbatojë kërkesat e Kodi Rrugor.

Pyetje: Z. Plarent Anamali, pyet sërish se nga marrëveshja me Policinë e Shtetit kush do mbajë përgjegjësinë e dëmeve dhe ku do vilet taksa e parkimit të mjeteve të depozituara?









Grupi i punës sqaron: Aktualisht nuk ka marrëveshje me shkrim me Drejtorinë Vendore të Policisë, por deri sa të kemi një të tillë, do bashkëpunohet me Policinë Rrugore që procedura e bllokimit të mjetit të bëhet nga ana e tyre në ambjentet që ata kanë në përdorim, deri sa ne si bashki të kemi një pikë bllokimi. Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit parashikohet edhe në Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”. Taksa e parkimit vilet nga institucioni i Policisë së Shtetit.

DEGJESE PUBLIKE : Dt:04.10.2023

REGULLORE "PËR CAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN ADMINISTRATIV SHKODËR"

RREGULLORE: "PËR MENSXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA URBANE (MNU) BASHKIA SHKODËR"

LISTE PREZENCE

Nr.	Emri Mbiemri	LAGJA/FSHATI	Kontakt (Nr. tel)	e-mail	Firma
	Rubin Borshi	NR 2	0699224548		
	Placet Arsonel.	Nr. 1	0696769123		
	Besmir Hobolli	Nr. 1	0692404375		
	Ornel Gjoni	XHedris SLPK	0692074468		
	Anton Deda	Nr. 3	0695324024		
	Bismir mullik	Improtor	0672175390		
	Drini Bushati	Rajoni 3 Biznes	0672020282		
	David Udoja	ADMINISTRATOR L.nr5	0699803189	donadoja@com.univ .com	

Marinela Amela	Nr 5	0693924906		
Jurgena Bračaj	Mesia Adm Postribē	0677399105		
Anden Kollaci	Holm Lyj. Nr 4	0676063076		
Eduard Sume	Inspr. Logija Nr 4	0694803674		
Admel Nendica	Biznes Privat	0699109116		
Vilsebeg Gurishta	SPV. Jumba	0693414000		
Imis Gurishta	SPV "Imis Gurishta"	0684053352		
Arda Shllaku	D. Mjodori Baku			
Burco Lajza	Dnykno Jurdica	0694655123		
Florinda Hily	D.E. Ksatri	0692061724		
ELIS CAMAY	D. SH. PUBLIKE	0693113459		
Agon Krijaj	D. SH. Publike	0682301798		
Eeri Naku	D. SH. Publike	0692762665		
Abi Zeman	Dnykno obzorne	0692168028		
ELWIN HOKHA	OJF	0694025418		
Gene Kodra	Biznes	0672023643		
Faton Kavaj	Biznes	0672014418		
Rejmenla	Publik			
Bledar Brahimataj	Biznes Adm. Nj.A. Postribē	0684142631		
Kolevan Skulco	Nj.A. Ana Molit	622256224		

elvin.hoxha@helena.org
 genc.kodra@yaho.com

Jana Legerie	KB	0694055172	jana.legerie@hs.com	Jana
Alisa Achmad	KB	0672014420	AlisaAchmad@pschodop.com	Alisa
Hoson Genta	KB	0682068819	hgentu@pmi.id.com	Hoson
Florian Malaj	Qytetarë Rrethina	0673121444	flor.malaj@e.com	Florian
Rezarta Pade	KB	0692437830	rezarta.pade@yahoo.com	Rezarta
Samed Burhati	K.B.	0697502002	samedburhati01@gmail.com	Samed
Gent Berati	SPAR FERAMARK	0695757705	FERAMARK@yahoo.com GENT.BERATI@yahoo.com	Gent
Uarda Qelbay	KB	0697036265	uarda_alb@yahoo.it	Uarda

Takim me komunitetin për teknikishterorje.

TAKIM PËR RREGULLOREN E MENAXHIMIT TE MBETJEVE URBANE - DATA 06/10/2023			
EMER	MBIEMER	KONTAKTI/NR I TELEFONIT	FIRMA
Sty Agim			
Davide Manaf			
Xhuliana	1 ku	(Rikultive) + Punaqajone postimi	
Fosha Bajrami			
Rifat Bajrami			
LITI MA SUFI			
Ermed Bajrami		= Rikultive	
Etleva Bajrami	→ për fshije e intronume 2 orë.		
Borukim Shkolliu		puncker komunele	
Alma Ismeti	→ për fshije e intronume 2		
Lirë Ismeti	→ për fshije e intronume 28 vjese		

